



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3089/ 6 prot.

Datë 31.01.2024

V E N D I M

Nr. 117/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.01.2024 me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*MF Invest Group*” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-78565-08-29-2023, me objekt “*Rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestre në shkollën e mesme të bashkuar Remas*” me fond limit 92,428,214.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 20.09.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjake.

Shfuqizimi i pjesshëm i Vendimit nr. 80, datë 24.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Divjakë
Lagjja nr.2, Sheshi “Santa Barbara”.

Ankimues:

BOE “*MFInvest Group*” SHPK, nr. NIPT J71830010R dhe “*Arkonstudio*” SHPK, me adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës*, Km 9, zona kadastrale 2005, nr. pasurie 1/94 (pranë OST-Se), Kashar.

Persona të interesuar:

Operatori ekonomik “*Kevin Construction*” SHPK, nr. NIPT K714011004Ë dhe me adresë: *Rruga “Adem Jashari” Nd.4 Hyrja 10, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë.*

Operatori ekonomik "2 N" SHPK, nr. NIPT L31615017L dhe me adresë: *Tiranë, Paskuqan, Lagjja "Paskuqan Fushë", Rruga "Demokracia", Pallati Nr. 2, Kati i Parë.*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" nenet 113, 114, 117, 118 dhe 136 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*" dhe neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik në Vendimin nr. 80, datë 24.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ kompetent për nxjerrjen e këtij vendimi konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë në Vendimin nr. 80, datë 24.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik si organ kompetent për nxjerrjen e këtij vendimi kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues, referuar Vendimit nr. 80, datë 24.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ kompetent për nxjerrjen e këtij vendimi, kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.5 Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “*MFinvest Group SHPK & Arkonstudio SHPK*”, referuar rishqyrtimit të Vendimit nr. 80, datë 24.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ kompetent për nxjerrjen e këtij vendimi, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankimes “*Kevin Construction*” SHPK është paraqitur në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.08.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*E hapur*” me nr. REF-78565-08-29-2023, me objekt “*Rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestere, në shkollën e mesme të bashkuar Remas*”, me fond limit 92,428,214.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.09.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjake.

II.2. Në datën 20.09.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 06.12.2023, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ <i>Kevin Construction</i> ” SHPK	68,768,028.80 lekë	Skualifikuar
2. “ <i>MFinvest Group</i> ” SHPK	70,985,797.00 lekë	Skualifikuar
3. “ <i>Colombo</i> ” SHPK	72,989,177.00 lekë	Skualifikuar
4. “ <i>Ina</i> ” SHPK	75,136,835.00 lekë	Skualifikuar
5. “ <i>FLED</i> ” SHPK	75,697,786.00 lekë	Skualifikuar
6. “ <i>Shendelli</i> ” SHPK	77,032,690.00 lekë	Skualifikuar
7. “ <i>2Z Konstruksion</i> ” SHPK	78,110,930.00 lekë	Skualifikuar
8. “ <i>2N</i> ” SHPK	78,187,358.00 lekë	kualifikuar
9. “ <i>Zdrava</i> ” SHPK	78,540,710.00 lekë	kualifikuar
10. “ <i>Jogi</i> ” SHPK	78,672,770.00 lekë	Skualifikuar
11. “ <i>Pepa Group Group</i> ” SHPK	81,063,841.70 lekë	Skualifikuar
12. “ <i>T&Xh</i> ” SHPK	82,151,778.00 lekë	Skualifikuar
13. “ <i>Eurovia SHPKNJ</i> ” SHPK	83,194,860.00 lekë	Skualifikuar
14. “ <i>Pe-Vla-Ku</i> ” SHPK	87,354,632.00 lekë	Skualifikuar
15. “ <i>O.B. Konstruksion</i> ” SHPK	88,747,037.00 lekë	kualifikuar
16. “ <i>Zeqillari</i> ” SHPK	89,026,072.64 lekë	Skualifikuar
17. “ <i>Xhast</i> ” SHPK	90,085,636.50 lekë	Skualifikuar
18. “ <i>Leon Konstruksion</i> ” SHPK	90,582,656.00 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 07.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 13.12.2023, në formë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi, nr. 3089 prot, e BOE “*MF Invest Group SHPK & Arkonstudio SHPK*” dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 7130/2, datë .20.12.2023, protokolluar pranë KPP-së me nr. 3082/3 prot., datë 29.12.2023, rezulton, se në datën 14.12.2023, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor. Ankesa lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3089/2 prot, datë 14.12.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.5.2. Në datën 20.12.2023, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 7130/2 prot., protokolluar në KPP me nr. 3082/3 prot., datë 29.12.2023, ka dërguar informacionin dhe vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues “Kevin Konstruktion” SHPK e BOE “*MFInvest Group*” SHPK, dhe “*Arkonstudio*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Me vendimin nr. 7130/1 prot., datë 20.12.2023, KSHA ka vendosur refuzimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II.5.3. Në datën 29.12.2023, në formë shkresore protokolluar me tonën me nr. 3089/3 prot., BOE “*MF Invest Group SHPK & Arkonstudio SHPK*”, ka paraqitur Formularin e Paraqitjes së Argumenteve, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

II.6. Në datën 24.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit administrativ me Vendimin nr. 80/2024, datë 24.01.2024, ka vendosur si më poshtë vijon:

1. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-78565-08-29-2023, me objekt “Rikonstruktion i objekteve ekzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestre në shkollën e mesme të bashkuar Remas”, me fond limit 92,428,214.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.09.2023, nga autoriteti kontraktor “Bashkia Divjakë”.*
2. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “MFInvest Group” SHPK dhe “Arkonstudio” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MF Invest Group” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK.*

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare, të paguar nga operatori ekonomik BOE “MFInvest Group” SHPK dhe “Arkonstudio” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas rishqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, informacionit të autoritetit kontraktor dhe Vendimit nr. 80/2024, datë 24.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik,

Arsyeton

III.1. Në datën 30.08.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur” me nr. REF-78565-08-29-2023, me objekt “Rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestre në shkollën e mesme të bashkuar Remas”, me fond limit 92,428,214.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20.09.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjake.

III.1.1. Në datën 20.09.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.2. Në datën 07.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 13.12.2023, në formë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi, nr. 3089 prot, e BOE “MF Invest Group SHPK & Arkonstudio SHPK” dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 7130/2prot., datë 20.12.2023, protokolluar pranë KPP me nr. 3082/3 prot., datë 29.12.2023, rezulton, se në datën 14.12.2023, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor. Ankesa lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij.

III.1.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3089/2 prot, datë 14.12.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.5. Në datën 20.12.2023, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 7130/2 prot., protokolluar në KPP me nr. 3082/3 prot., datë 29.12.2023, ka dërguar informacionin dhe vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesave të paraqitura nga

operatorët ekonomikë ankimes “Kevin Konstruktion” SHPK e BOE “MFInvest Group” SHPK, nr. NIPT J71830010R dhe “Arkonstudio” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Me vendimin nr. 7130/1 prot., datë 20.12.2023, KSHA ka vendosur refuzimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes, ku ndër të tjera ka cituar si në vijim: “... *Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Neni 110 pika 2, Neni 112 dhe Neni 114, si edhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, Neni 94, Neni 96 pika 1, Neni 100, Neni 101 dhe Neni 102, si edhe pasi u njoh me ankesën tuaj, protokolluar pranë Bashkisë Divjakë me Nr. 7129 Prot, datë 14.12.2023, pezulloi procedurën e prokurimit dhe autorizoi komisionin e caktuar për të shqyrtuar ankesën tuaj. ...”.*

III.1.6. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.*”.

III.1.7. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik*”.

III.1.8. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimes” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.*

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.9. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “*1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Në nenin 115 “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës. 2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë

autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, u konstatua, se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i fituesit më datë 07.12.2023. KPP vëren, se BOE “MFInvest Group” SHPK dhe Arkonstudio SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 13.12.2023, ku kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij. Nga verifikimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, rezulton, se autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje, ku citohet, se është administruar ankesa pranë autoritetit kontraktor më datë 14.12.2023.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor pas afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftim-fituesi më datë 07.12.2023.

Gjithashtu, KPP ju sjell në vëmendje, se bazuar në manualin e APP-së nr. 1, datë 24.12.2021 operatorët ekonomikë njoftohen mbi publikimin e njoftim - fituesit ose anulimit në sistem, sapo autoriteti kontraktor e ka kryer këtë veprim, dhe në këtë kuptim ezaurohen të gjitha mënyrat përmes të cilave operatorët ekonomikë të interesuar, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, vihen në dijeni mbi momentin e njoftimit të fituesit dhe rrjedhimisht mbi fillimin e afateve procedurale të ankimimit.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastin kur nga ofertat e dorëzuara në procedurën e prokurimit nuk rezulton asnjë ofertë e suksesshme, ose kur operatori ekonomik kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikim/skualifikimin e operatorëve të tjerë, nis ditën e publikimit të njoftimit të anulimit dhe ditën e publikimit të njoftim-fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor ka kaluar afatet ligjore të sipërcituara, pasi ankesa mban datën 14.12.2023 dhe afati përfundimtar për të dërguar ankesën, si në autoritet kontraktor ashtu dhe pranë KPP-së ishte data 13.12.2023.

Për sa më sipër, ankesa e paraqitur në mënyrë shkresore pranë autoritetit kontraktor me datë 14.12.2023, konsiderohet e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.2. Nisur nga konstatimet e pikës III.2 të këtij vendimi, Komisioni i Prokurimit Publik me iniciativën e tij konstaton se,

Në nenin 114 të ligjit nr. Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë.

III.2.1. Në nenin 113 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit” të ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishtëm.

3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.”.

Në nenin 117, “Afati për anulimin dhe shfuqizimin” e ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Shfuqizimi, në rastin e parashikuar në pikën 1, të nenit 116, të këtij Kodi, mund të bëhet në çdo kohë.

2. Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet

që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.”.

III.2.2 Me nismën e vetë organit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se referuar Vendimit KPP 80/2024, të datës 24.01.2024, në pjesën “Rrethanat dhe faktet”, përkatësisht pikës II.7, është pasqyruar saktë informacioni lidhur me paraqitjen e ankesës së operatorit ekonomik BOE “MFInvest Group” SHPK, dhe Arkonstudio SHPK”, ku citohet se pranë autoritetit kontraktor ankesa është paraqitur më datë 14.12.2023, referuar kjo nga marrja e informacionit të autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e depozituar pranë Autoritetit Kontraktor.

Nisur nga ky konstatim, Komisioni Prokurimit Publik, në interpretim të bazës ligjore të sipërpërmendur, mund të ushtrojë me iniciativën e tij kompetencën si organ publik administrativ për të shfuqizuar pikat I.5 , III.2 deri në III. 2.8 dhe pikat 2,3 dhe 5 në dispozitivin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 80, datë 24.1.2024, pasi referuar pikës III.2 të këtij vendimi, bashkimi i operatorëve ekonomikë “MFInvest Group” SHPK dhe “Arkonstudio” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 110, pika 2, “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në paraqitjen e ankesës pranë autoritetit kontraktor.

III.2.3 Në interpretim të neneve 113, 114, 117 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni konstaton, se ligjvënësi ka përcaktuar qartë kompetencën e organit publik administrativ, që të shfuqizojë plotësisht ose pjesërisht një akt administrativ me iniciativën e tij, duke pushuar pasojat juridike të këtij akti administrativ. Gjithashtu, Kodi i Procedurave Administrative, ka parashikuar edhe formën e shfuqizimit të aktit administrativ me një akt të ri, të arsyetuar me shkrim.

Në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik mbështetet edhe në parimet kryesore të kufizimit të diskrecionit parashikuar nga neni 114, i Kodit të Procedurave Administrative. Ndaj në vendimmarrjen për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit, KPP mbështetet edhe në parimet themelore të kundërta të së drejtës administrative, për të gjetur një balancë të përshtatshme midis tri interesave të mbrojtura ligjërisht që mund të preken nga shfuqizimi i një akti, siç janë:

- a) Ligjshmëria, e cila thekson shprehimisht se qëllimi i vetëm që mund të justifikonte shfuqizimin e një akti administrativ të paligjshëm është rivendosja e ligjshmërisë.
- b) Siguria juridike, e cila konsiston në faktin se veprimi i paligjshëm është shfuqizuar me qëllim të rivendosjes së ligjshmërisë
- c) Interesi individual në vazhdimësinë e të drejtave të fituara.

Gjithashtu, në gamën e parimeve të mësipërme, KPP vlerëson, se edhe interesi i individit i cili preket nga shfuqizimi i këtij vendimi nuk është i cenuar, pasi për faj të vetë ankimuesit, ky i fundit ka dorëzuar një ankesë jashtë afateve të parashikuara nga ligji i prokurimit publik, pranë autoritetit kontraktor. KPP ka ritheksuar tashmë në vendimmarrjen e konsoliduar, përfshirë edhe ato vendimmarrje mbi interpretimin e dispozitave, të zbatueshme për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, mbi mënyrën e llogaritjes së afateve, si pranë autoritetit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërkohë, në shfuqizimin e aktit, KPP ka rivendosur ligjshmërinë në vendimmarrjen e tij, duke mos cenuar interesat e ligjshëm të subjekteve të interesuara në këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik shfuqizon pjesërisht vendimin nr. 80\2024, datë 24.01.2024 .

Për sa më sipër, në mbështetje të ”, neneve 113, 114, 117, dhe 136 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të shfuqizojë pjesërisht vendimin nr. 80/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, datë 24.01.2024, për pikat I.5 , III.2, deri në III. 2.8 dhe në dispozitivin e vendimit pikat 2, 3 dhe 5.
 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik BOE “MFInvest Group” SHPK dhe “Arkonstudio” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-78565-08-29-2023, me objekt “Rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë anësore dhe ndërtim palestere në shkollën e mesme të bashkuar Remas”, me fond limit 92,428,214.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.09.2023, nga autoriteti kontraktor “Bashkia Divjakë”.
 3. Arsyetimi dhe dispozitivi lidhur me çështjet e tjera të trajtuara në vendim mbeten në fuqi.
 4. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik BOE “MFInvest Group” SHPK dhe “Arkonstudio” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

